



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Dekanati i FSHMN-së

Prishtinë, 05.05.2020

N J O F T I M

Për regjistrimin e semestrit veror të vitit akademik 2019/2020

Njoftohen studentët të cilët për herë të parë janë regjistruar në FSHMN, para vitit akademik 2019/20 dhe që nuk i kanë kryer obligimet administrative për regjistrim të semestrit veror dhe obligimet nga vitet akademike paraprake, këtë mund ta bëjnë nga data **05.05.2020 deri më 08.05.2020 ora 16.00 (E martë-premtë)**.

Paralajmërojmë të gjithë studentët të cilët gjatë periudhës së hapjes së SEMS-it nuk i kryejnë obligimet për regjistrim të semestrit veror, se nuk do të kenë mundësi tjetër për regjistrim të semestrit veror të akademik 2019/20, rrjedhimisht këta studentë nuk do të kenë të drejtë t'i nënshtrohen provimeve të afateve vijuese gjatë vitit akademik 2019/20.

Ky njoftim për pagesë të semestrave vlen edhe për studentët të cilët gjatë këtij viti akademik presin ti nënshtrohen mbrojtjes së temës së diplomës dhe të cilët nuk janë të liruar nga pagesa sipas Ligjeve apo vendimeve në fuqi.

Procedura e regjistrimit online të semestrit veror 2019/20

Studenti pasi ta kryej pagesën elektronike të semestrit, obligohet që një kopje të dëshmisë së pagesës ta dërgoj në adresë/email të zyrarit përkatës të shërbimit të studentëve, ndërsa kopjen fizike obligohet që ta dorëzoj në momentin e parë që krijohen rrethanat.

Zyrtari i shërbimit të studentëve duhet të evidentoj rastet e paraqitura në këtë formë dhe në asnjë rrethanë të mos e konfirmojë në sistem lejen për pajisje me diplomë, nëse studentin nuk e dorëzon dëshminë fizike të pagesës së semestrit.

Të gjitha pagesat e realizuara brenda periudhës së sipërshënuar dhe ato të cilat janë kryer pas mbylljes së afatit paraprak por që nuk janë pranuar nga shërbimi, duhet të merren në konsideratë për regjistrim të semestrit veror 2019/20.

Dekanati i FSHMN-së